



Prishtinë: 12.10.2012

Kodi i ZRRE-së: V_474_2012

Nr. i Referencës: ZRRE/DMK_V_828_07_12

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke marrë parasysh:

1. Kompetencat e Zyrës së Rregullatorit për Energji të dhëna në nenin 14 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë;
2. Dispozitat sipas Kreut IV, nenit 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
3. Dëshmitë e paraqitura nga palët;
4. Vendimin e DMK të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_V_828_07_12**; dhe
5. Ankesën e KEK-ut me datë 31.08.2012.

Në mbledhjen e mbajtur më 12 tetor 2012 nxori këtë:

VENDIM

- I **REFUZOHET** ankesa e KEK-ut ndaj vendimit të DMK-së për konsumatorin S. Ll. (shifra në KEK: DPR - 40084), nga Prizreni, si në arsyet e paraqitura në arsyetimin e këtij vendimi.
- II **MBETET në fuqi** vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve nr. ZRRE/DMK_V_828_07_12 i datës 23.07.2012.

Arsyetim

Konsumatori S. Ll. me datë 30.12.2011 ka bërë kërkesë në KEK me të cilën ka kërkuar nga KEK-u, që t'i mundësoj lidhjen e re për furnizim me energji elektrike.

Pas kërkesës së konsumatorit për lidhje të re, punëtoret e autorizuar të KEK-ut për ndërrim njehsori me datë 28.03.2012 kanë dal te konsumatori dhe kanë bërë ndërrimin e njehsorit elektrik, ku kanë konstatuar se nuk prezantohet njehsori elektrik nr. 11650240 dhe kanë bërë zyrtarizmin e njehsorit të ri elektrik nr. 97017779, ku edhe është bërë regjistrimi i të gjitha pajisjeve që posedon konsumatori.

Departamenti i Faturimit në KEK me datë 13.04.2012 ka ngarkuar konsumatorin me shifër DPR - 40084 me ngarkesë për shfrytëzim të paautorizuar të energjisë elektrike DPR12HP10975 në vlerë prej 149.64€. Pas kësaj ka bërë ankesë në Departamentin për Konsumator në KEK duke kërkuar që ti mundësoj krijimin e lidhjes së re në mënyrë që të bëjë pagesën për atë çka shpenzoi e jo të paguaj energjinë e shpenzuar nga fqiu. Departamenti për Konsumatorë në KEK ka shqyrtuar lëndën e konsumatorit ku edhe ka refuzuar ankesën e tij. Konsumatori pas marrjes së përgjegjës nga ana e KEK-ut, brenda afatit ligjor ka parashtruar ankesë në Departamentin për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE me të cilin ka kundërshtuar ngarkesën për shfrytëzim të paautorizuar të energjisë elektrike.

Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve ka bërë shqyrtimin e ankesës së konsumatorit dhe me datë 30.07.2011 ka nxjerr vendim duke aprovuar ankesën e konsumatorit dhe duke kërkuar nga KEK-u që të KEK-u është i obliguar që t'i mundësoj lidhje të re konsumatorit sipas kërkesës së bërë me datë 30.12.2011, si dhe KEK-u pasi që t'i mundësojë lidhjen e re konsumatorit S. Ll. duhet të ngarkojë



konsumatorin me borxhin e krijuar nga data 30.12.2011 e tutje kur edhe ka filluar të faturohet si konsumator i rregullt i energjisë elektrike në pikën e re matëse.

Pas marrjes së vendimit të DMK-së, me datë 31.08.2012 KEK-u ka parashtruar ankesë në Bordin e ZRRE-së ndaj këtij vendimi, me të cilën ka kundërshtuar në tërësi vendimin e DMK-së nr. ZRRE/DMK_V_828_07_12 të datës 23.07.2012, dhe njëherit ka propozuar që aprovohet kundërshtimi i KEK-ut dhe borxhi i theksuar më sipër të ngelet kontest deri në përfundimin e të gjitha procedurave ligjore.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 12 tetor 2012 ka analizuar dëshmitë e paraqitur nga ana e KEK-ut, përkatësisht bazën e kundërshtimit për mos prezantimin e njehsorit elektrik si dhe KEK-u e ka mundësuar lidhje të re me 28.03.2012 por konsumatori fsheh njehsorin elektrik.

Bordi i ZRRE-së ka analizuar kontratën e shitblerjes mbi paluejtshmërinë e lidhur me datë 17.01.2011 në mes palëve kontraktuese A. (Z) K. dhe S. (I) Ll. të dytë me banim në fshatin Bardhosh KK Prishtinë, dhe ka vërejtur se kontrata është e vërtetuar në Gjykatën Komunale në Prishtinë. Po ashtu Bordi ka analizuar edhe Aktvendimin e Komunës së Prishtinës nr. 010-413/111-559 e datës 17.01.2011 me të cilën vërtetohet se S. Ll. nga Bardhoshi ka blerë patundshmërinë nga A. K. dhe me këtë rast i caktohet taksa në transaksion të pronës së patundshme në shumë prej 150€, baza për caktimin e kësaj takse është marr nga kontrata mbi shitblerjen e patundshmërisë, kopjen e planit të lëshuar nga Drejtoria e Kadastrit në Komunën e Prishtinës me parcelë nr. 426-2, me pronar A. (Z) K.

Bordi i ZRRE-së ka analizuar edhe procesverbalet tjera të KEK-ut dhe gjatë analizës ka vërejtur se edhe përkundër kërkesës së konsumatorit për lidhje të re, KEK-u nuk i ka ofruar lidhje të re në arsyetimin se konsumatori fillimisht duhet të bëjë pagesën e borxhit të krijuar më herët lidhur me shifrat DPR- 40084 dhe DPR – 40085. Nga transaksionet e konsumatorit të këtyre shifrave vërehet se borxhi në shifrën DPR – 40084 është i evidentuar në emër të një pronari serb Dj. R. Nga kjo vërehet se konsumatori S. Ll. në bazë të kontratës mbi shitblerjen e paluejtshmërisë e lidhur me datë 17.01.2011 dhe të vërtetuar nga Gjykata Komunale në Prishtinë shihet se është pronar i paluejtshmërisë pjesa e pronës 1/1, ngastra kadastrave me numër të njësisë –P-71914021-00426-2 me sipërfaqe prej 5002 dhe se sipas dokumentacioneve nga Drejtoria për Kadastër Parcela për të cilën konsumatori e ka blerë nuk ka të bëjë me pikën matëse me të cilën është krijuar borxhi i energjisë elektrike dhe kjo vërtetohet edhe në certifikatën e paluejtshmerisë.

Është analizuar edhe shpenzimi i energjisë elektrike i shifrës DPR – 40084 dhe nga analiza vërehet se konsumatori është faturuar nga ana e KEK-ut me faturim pa matje/paushall deri në periudhën 05/2009. Po ashtu vërehet se KEK-u në periudhën 05/2009 e pasivizuar shifrën e konsumatorit DPR – 40084 me borxhi të energjisë elektrike të krijuar deri në atë periudhë prej 4,575.19€, si dhe aktivizimi i shifrës së konsumatorit ka ndodhur me datë 07.04.2012, kur edhe konsumatori ka parashtruar kërkesë për lidhje të re.

Kundërshtimet e KEK-ut të theksuara në ankesë se konsumatori fsheh njehsorin elektrik dhe meqë rast ka bërë veprë penale nga neni 252 i KPK, kanë të bëjnë me elemente të veprës penale dhe se Bordi i ZRRE-së pas analizimit dhe vlerësimit të ankesës së KEK-ut thekson se ZRRE nuk bënë shqyrtimin e elementeve të veprës penale, por ka shqyrtuar mos ofrimin e lidhjes së re konsumatorit nga KEK-u, si dhe faturën e shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë elektrike të ngarkuar nga KEK-u. Duhet theksuar se gjatë analizës së vërejtur se konsumatori ka ofruar të gjitha dëshmitë se ka blerë pronën nga A.(Z) K. (kontrata e shitblerjes) dhe të gjitha dokumentacionin tjetër të lëshuar nga Komuna e Prishtinës (Aktvendimin e Komunës së Prishtinës, kopjen e planit, certifikatën e plaujtshmërisë) ku vërehet se parcela e cila është blerë nga konsumatori nuk ka të bëjë me pikën matëse me të cilën është krijuar borxhi i energjisë elektrike dhe se edhe sipas shpenzimeve të energjisë elektrike të analizuara është vërejtur se shifra për të cilën pretendon KEK-u është faturuar



vazhdimisht me faturim pa shpenzim por me faturim pa matje/paushall. Nga transaksionet e konsumatorit është vërejtur vet KEK-u ka bërë pasivizimin e kësaj shifre dhe vet ka aktivizuar shifrën. Bordi i ZRRE-së duke i marrë për bazë të gjitha argumentet e theksuara më lart, konstaton se vendimi i DMK-së, është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Bordi i ZRRE-së ka vlerësuar se KEK-u në ankesën e tij nuk ka prezantuar asnjë provë të vetme me të cilën e vërteton faktin se vendimi i DMK-së nuk është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligj, gjithashtu ankesa e KEK-ut, nuk i përmban elementet bazë të një ankese pasi që është shumë e mangët për kah përmbajtja. Kundërshtimet që janë dhënë në ankesë nuk i referohen se cilat dispozita ligjore janë shkelë nga ana e DMK-së, gjatë nxjerrjes së vendimit, por që KEK vetëm është thirr në formën e përgjithësuar pa konkretizuar decidivisht se ku janë bërë shkeljet gjatë nxjerrjes së këtij vendimi.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 12.10.2012 ka analizuar ankesën e KEK-ut dhe vendimin e nxjerrë nga ana e DMK-së nr. ZRRE/DMK_V_828_07_12, dhe pas analizimit të hollësishëm të të gjitha dëshmime tjera të prezantuara në shkresat e lëndës ka vendosur në dispozitivin e këtij vendimi.

Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimi të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së

Enver Halimi, kryesues

Përparim Kabashi, anëtar

Blerim Koci, anëtar

Merita Kostari, anëtare

Krenar Bujupi, anëtar